



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR
MINISTRINË E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Arian Haxha (udhëheqës ekipi), Fatlinda Podvorica dhe Veton Misiri (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Shkëlqim Xhema.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm.....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	24
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	27
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	33
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	35

Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2018, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 14/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se ishin kryer pagesa nga kategoria subvencione dhe transfere në vlerë totale prej 1,166,982€ pa bazë të qartë ligjore. Gjithashtu ishin kryer pagesa në vlerë 105,124€ për paga dhe mëditje në mungesë të dëshmive për vijueshmërinë në punë.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të MPMS-së gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar dhe se një proces auditimi mund të ndërmerret.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Auditimin e kemi kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Gjatë vitit 2018 MPMS kishte kryer pagesa nga kategoria subvencione dhe transfere në vlerë totale 1,166,982€ pa bazë të qartë ligjore. Këto kanë të bëjnë me pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve në vlerë 146,374€, përfituesve të pensioneve nga persona të cilët punojnë apo që realizojnë të ardhura personale në vlerë 454,779€ si dhe përfituesve nga më shumë se një skemë pensionale të financuara nga MPMS-ja në vlerë 565,829€; dhe

- Bazuar në marrëveshjen e Brukselit të dt.26.03.2015 dhe Vendimit të Qeverisë Nr.06/39 i dt. 22.07.2015, 30 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur "Mbrotjtja civile" ishin caktuar në departamente të ndryshme të MPMS-së¹ në veri të vendit. Prej tyre, për 22 zyrtar MPMS-ja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi siç janë: vijueshmëria në punë apo raportet për punën e kryer gjatë vitit 2018. Shpenzimet e pagave gjatë vitit 2018 për këta zyrtarë ishin 105,124€, dhe vazhdojnë edhe më tutje pavarësisht faktit që MPMS nuk ka ndonjë dëshmi se këta zyrtarë janë duke punuar.

Opinionit i auditimit nuk është kualifikuar për këto çështje pasi që vlera e gabimit nuk e tejkalon materialitetin e përcaktuar nga ZKA. Për më gjerësisht referojuni nën kapitullit 3.6 Subvencionet dhe Transferet.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

¹ Prej tyre, 22 të caktuar në departamente të ndryshme të MPMS-së në veri të vendit dhe 8 në Agjencionin e Punësimit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MPMS-së i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Lidhur me këto kërkesa, ne kemi marrë parasysh çështjet e mëposhtme:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 01/2013 për Shpenzimet e Parave Publike dhe Rregulloren Financiare 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Në kontekst të PFV-ve, kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Tek neni 18 - Detyrimet kontingjente - ishin shpallur detyrime kontingjente në vlerë 16,609€, ndërsa vlera që do të duhej të shpalosej ishte 8,836€ (kemi një mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për 7,773€).

Kjo ka ndodhur për shkak të kujdesit jo të duhur me rastin e përgatitjes së PFV-ve, ku pesë fatura në vlerë 7,773€ të cilat ishin paguara gjatë vitit 2018 janë prezantuar si detyrime kontingjente;

- Tek neni 19.3.1 Pasuritë kapitale mbi 1,000€ - Vlera e pasurive kapitale mbi 1,000€ e shpallur në PFV është 18,822,098€, kjo vlerë ishte mbivlerësuar për 44,903€, pasi që pagesa e njëjtë është regjistruar dy herë në regjistrin e pasurisë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të ndërrimit të stafit me rastin e pensionimit të zyrtarit të pasurisë.

- Në dy rast kemi vërejtur se pagesa në vlerë 137,725€ për shpenzimet e provizionit bankar sipas natyrës së shpenzimit dhe planit kontabël i takon kategorisë mallra dhe shërbime, ndërsa ishin paguar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, duke rezultuar me nënvlerësim të mallrave dhe shërbimeve dhe mbivlerësim të subvencioneve dhe transfereve të prezantuara në PFV. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura te theksim i çështjes dhe pajtueshmëria me kërkesat për PFV jepen rekomandimet:

Rekomandimi B1 Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Po ashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.

Rekomandimi A1 Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë është mjaft i përhapur edhe në ministrinë tjera.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shpalosjen e saktë të pasurive dhe detyrimeve kontingjente. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në kode adekuate siç parashihet me planin kontabël të SIMFK-së me qëllim të prezantimit dhe shpalosjes së drejtë të informatave për shfrytëzuesit e PFV-ve.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Megjithëse, kishte përmirësime sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit gjatë vitit 2018, ende nevojiten veprime shtesë për një menaxhim financiar dhe kontroll të mirëfilltë. Në kontekst të sistemeve financiare, duhet të forcohen kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsitë dhe shpenzimet jo racionale.

Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë fusha e subvencioneve, si fushë më shqetësuese për shkak vonesave në eliminimin e paqartësive rregullative dhe moszbatimit të kërkesave ligjore me rastin e pagesave të pensioneve për personat e punësuar, pagesat pas vdekjes së përfituesve si dhe pagesat për personat që përfitojnë më tepër se një pension, pastaj pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbime, investimet kapitale menaxhimi i pasurisë si dhe menaxhimi i obligimeve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	408,741,593	443,143,143	441,839,080	400,156,325	376,550,042
Granti i Qeverisë -Buxheti	408,741,593	442,437,883	441,479,041	399,879,722	376,407,020
Donacionet e jashtme	0	705,260	360,039	276,603	143,022

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 34,401,550€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme në vlerë 705,260€, dhe vendimeve të Qeverisë në vlerë 33,696,290€. Në këtë rritje ka ndikuar ndarja e mjeteve për mbulimin e obligimeve tek skema e veteranëve të luftës.

Në vitin 2018, MPMS ka shpenzuar 99.7% të buxhetit final, ngjashëm me vitin paraparak 2017.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	408,741,593	443,143,143	441,839,080	400,156,325	376,550,042
Pagat dhe Mëditjet	5,194,944	5,085,867	5,085,867	4,872,972	4,848,167
Mallrat dhe Shërbimet	1,772,538	1,965,029	1,780,499	1,926,237	3,058,654
Shërbimet komunale	377,085	321,407	289,864	316,560	342,875
Subvencionet dhe Transferet	398,401,647	435,027,484	433,997,243	392,236,724	367,754,672
Investimet Kapitale	2,995,379	743,356	685,607	803,832	545,674

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur janë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim më atë fillestar ishte zvogëluar për 109,077€, si rezultat i shkurtimeve buxhetore me vendime të Qeverisë². Në këtë kategori, buxheti final ishte realizuar në tërësi;
- Në krahasim me buxhetin fillestar, te mallrat dhe shërbimet buxheti final ishte rritur për 192,491€. Rritja e buxhetit ishte rezultat i donacioneve të jashtme në vlerë 85,491€ si dhe rritjes me vendim të Qeverisë në vlerë 107,000€³ përmes transfereve nga kapitalet dhe komunalit. Shpenzimi në këtë kategori ishte 91% e buxhetit final;
- Buxheti për shpenzime komunale ishte zvogëluar për 55,678€. Kjo ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë⁴ për kursime buxhetore në vlerë 28,678€ dhe transferit të mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë 27,000€. Realizimi ishte 90% e buxhetit final;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte rritur për 36,625,837€ krahasuar me atë fillestar. Në këtë rritje ka ndikuar ndarja e mjeteve për mbulimin e obligimeve tek skema e veteranëve të luftës. Për këtë kategori realizimi ishte 99.8% e buxhetit final; dhe
- Buxheti final i investimeve kapitale ishte më i ultë për 2,252,023€ krahasuar me atë fillestar. Fillimisht buxheti ishte rritur si rezultat i transferimit të mjeteve nga kategoria subvencione dhe transfere në vlerë 500,000€ si dhe donacioneve të jashtme në vlerë 2,292€. Pastaj buxheti ishte zvogëluar në vlerë 2,754,315€ si rezultat i shkurtimeve buxhetore dhe transferimit të

² Vendimi i Qeverisë Nr.02/70, dt. 19.10.2018 dhe Vendimi Nr. 07/80, dt. 18.12.2018.

³ Vendimi i Qeverisë Nr.11/79 ,dt 11.12.2018, transfere prej kapitaleve 80,000€ dhe komunalive 27,000€

⁴ Vendimi i Qeverisë Nr.11/79 ,dt 11.12.2018 transfere në mallra 27,000€ dhe Vendimi i Qeverisë Nr. 07/80, dt. 18.12.2018 kursime buxhetore 28,678€.

mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime me vendime të Qeverisë⁵. Shpenzimet në këtë kategori ishin 92% e buxhetit final.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MPMS në 2018 ishin në vlerë 608,429€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga Autoriteti i Inspektoratit të Punës (AIP) dhe Departamenti për Punë dhe Punësim (DPP).

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	608,429	329,374	247,958
Totali	608,429	329,374	247,958

Krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje të hyrave prej 85%. Në rritjen e të hyrave kryesisht kanë ndikuar gjobat nga inspektorati i punës. Këto të hyra transferohen në buxhetin e Kosovës dhe nuk shfrytëzohen nga Ministria.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte në vlerë 5,085,867€ i cili ishte realizuar në tërësi (100%). Numri i aprovuar i të punësuarve në MPMS ishte 855 ndërsa numri aktual në fund të vitit 2018 ishte 801 punonjës sipas PFV. Për 54 pozitat e lira, MPMS nuk kishte arritur plotësimin e tyre përkundër që ishin të përfshira në planin e rekrutimit.

Lidhur me testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

⁵ Vendimeve të Qeverisë: Nr.04/74 i dt. 06.11.2018; Nr.11/79 i dt. 11.12.2018; Nr.07/80 i dt 18.12.2018; dhe Nr.12/81 i dt. 24.12.2018 ishte zvogëluar buxheti për 2,754,315€

Çështja A3⁶ - Dobësi gjatë procesit të rekrutimit**Gjetja**

Sipas nenit 7 të Ligjit 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm - auditori i brendshëm duhet të ketë licencë nga NJQH e Auditimit të Brendshëm, ndërsa neni 16 përcakton se në mungesë të licencës kandidatët mund të pranohen vetëm si praktikantë. Po ashtu, gjatë procesit rekrutues duhet të zbatohet rregullorja Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Në konkursin e rekrutimit të dt.01.12.2017 për pozitën "Auditor i Brendshëm" identifikuaam parregullsitë si në vijim:

- MPMS-ja kishte rekrutuar në pozitën e auditorit të brendshëm dy kandidatë të cilët nuk posedonin licencë përkatëse për të punuar në këtë pozitë; dhe
- Kjo pozitë nuk ishte planifikuar në planin e përgjithshëm të personelit, si dhe ishte përcjellur me parregullsi në pranimin e aplikacioneve, përpilimit të listës së ngushtë sa i përket afatit kohor si dhe mos informimi me shkrim i kandidatëve të cilët i'u kanë nënshtruar testimit me shkrim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrollit jo të mirë dhe përcaktimit të kriterëve jo konform ligjit në konkursin për auditor të brendshëm.

Rreziku

Dobësitë në procedurat e rekrutimit si dhe mos respektimi i kriterëve të përcaktuara në ligjin për auditimin e brendshëm me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën auditor të brendshëm rrit rrezikun e punësimit të stafit jo kompetent. Njëherit kjo mund të dëmtojë cilësinë e punës së NJAB-it.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të forcoj kontrollin e brendshëm dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të stafit, kriteret përcaktohen sipas legjislacionit përkatës duke respektuar në tërësi procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.

⁶ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura

Çështja C2- Dobësi në angazhimin e stafit sipas marrëveshjeve për shërbime të veçanta

Gjetja Sipas Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil (nenit 12 pika 4), emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Lidhur me këto, ne kemi vërejtur që MPMS gjatë vitit 2018 kishte angazhuar 14 zyrtarë përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta (MSHV), ku pas përfundimit të kontratave ju kishin vazhduar prapë ato. Prej tyre në një rast, Ministria nuk ka zbatuar procedurën e thjeshtësuar të rekrutimit.

Për këtë MPMS nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për të konfirmuar se njësitë kërkuese kanë parashtruar kërkesë për të konfirmuar nevojën e angazhimit të këtyre zyrtarëve.

Rreziku Dobësitë e identifikuara mund të rezultojnë me mungesë të mirëfilltë të konkurrencës dhe cilësi të dobët të shërbimeve të ofruara. Në mungesë të kontroleve, Ministria rrezikon të angazhoj persona jo kompetent për pozitat përkatëse si dhe rritje të shpenzimeve të pa planifikuara që mund të ndikojnë në ngecjen e realizimit të objektivave tjera të përcaktuara.

Rekomandimi C2 Ministri duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalit) në vitin 2018 ishte 2,286,436€. Prej tyre ishin shpenzuar 2,070,363€ apo 91% e buxhetit. Këto shpenzimet kanë të bëjnë me furnizime me material shpenzues, mirëmbajtje, pajisje të IT-së, derivate, shërbime kontraktuese, shërbime komunale etj.

Lidhur me testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja A4 - Pagesat për kompensimin e stafit për punë shtesë

Gjetja Neni 80 i Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, citon: nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur.

MPMS-ja kishte anashkaluar kërkesat ligjore duke kompensuar stafin e angazhuar në komisione të ndryshme⁷ gjatë orarit të rregullt të punës. Vlera totale e këtyre kompensimeve ishte 30,013€ të cilat ishin paguar nga kategoria mallrave dhe shërbimeve me aprovim të ZKA-së.

Shkaku i këtyre kompensimeve sipas menaxhmentit të MPMS-së ishte motivimi i stafit, pasi që në mungesë të kompensimit stafi hezitojnë të angazhohen në komisione të tilla.

Rreziku Pagesat për kompensimin e stafit për punë shtesë brenda orarit të rregullt të punës është në kundërshtim me legjislacionin duke rezultuar me pagesa të parregullta dhe njëkohësisht ndikon në dëmtim të buxhetit.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të sigurojë se nuk do të ketë asnjë kompensim shtesë për stafin e angazhuar brenda orarit të rregullt të punës.

⁷ Komisionet mjekësore (mjekët që janë në listë të pagave të MPMS-së) vlera e kompensimit 18,238€; Komisionet e AIP (Inspektorati i Punës) vlera e kompensimit 6,600€, dhe Komisioni i përgjithshëm për shërbime sociale dhe familjare (KPSHSF) vlera e kompensimit 5,175€.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 435,027,484€. Prej tyre në vitin 2018 ishin shpenzuar 433,997,243€ apo 99.8%. Megjithëse kishte përmirësime sa i përket menaxhimit të skemave pensionale dhe sociale ende mbetet sfidë për MPMS menaxhimi i mirëfilltë i tyre.

Për dallim nga viti i kaluar ku gabimi ishte 1,913,630€, këtë vit vlera e gabimet është 1,166,982€ me një zvogëlim prej 746,648€ në raport me vitin e kaluar.

Për më tepër, ne kemi identifikuar çështjen si në vijim:

Çështja A5 - Pagesat pa bazë të qartë ligjore

Gjetja Bazuar në krahasimin e të dhënave të MPMS-së për skemat pensionale dhe ndihmat sociale me të dhënat e ATK-së dhe ARC-së, kemi konstatuar se MPMS kishte kryer pagesa pa bazë të qartë ligjore si në vijim:

- Përfitimi i pensioneve apo ndihmave sociale nga persona të cilët punojnë apo realizojnë të ardhura personale. Vlera e pagesave për vitin 2018 ishte 454,779€. Vlen të ceket se sa i përket pagesave të ndihmave sociale për personat e punësuar nuk kemi hasur ndonjë rast pas muajit prill 2018;

Tabela 4. Përfitimet e pensioneve nga personat e punësuar (në euro)

Lloji i skemës pensionale	Numri i pagesave	Gabimi Financiar
Pensionet Trepça	146	15,540
DFDIL- Veteran	2,374	398,567
Ndihma Sociale	378	40,672
Gjithsej	2,898	454,779

- Pagesa e pensioneve pas vdekjes së përfituesve, vlera e të cilave ishte 146,374€. Kjo kishte ndodhur për arsye se regjistrimi i vdekjeve në ARC ishte bërë me vonesë dhe për këto raste MPMS nuk ishte në dijeni; dhe

Tabela 5. Pensionet e paguara pas vdekjes së përfituesve

Lloji i pensionit (skemës pensione)	Pagesat për përfituesit që kanë vdekur para vitit 2018		Pagesat për përfituesit që kanë vdekur gjatë vitit 2018		Totali i pagesave pas vdekjes së përfituesve	
	Nr. i pagesave	Shuma (€)	Nr. i pagesave	Shuma (€)	Nr. i pagesave	Shuma (€)
Kompensim për persona të verbër (KV)	8	1,875	5	1,625	13	3,500
Pensionet Bazë (PB)	136	10,200	311	25,575	447	35,775
Pensionet Kontributive (PK)	26	6,558	102	19,035	128	25,593
Pensionet për personat me aftësi të Kufizuara (PPAK)	49	4,125	40	3,450	89	7,575
Pensionet Trepça	7	735	8	840	15	1,575
DFDIL Familjar	2	736	31	8,269	33	9,006
DFDIL Veteran	20	3,910	19	3,230	39	7,140
Pensionet e TMK-së	11	2,794	0	0	11	2,794
Pensionet për paraplegjikët dhe tetraplegjikët (PPTP)	38	24,600	38	26,236	76	50,836
Pensionet Familjare	12	1,905	2	675	14	2,580
Gjithsej	2,326	57,438	2,546	88,935	865	146,374

- Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale, ku rastet më të shpeshta të këtyre përfituesve i takojnë kategorisë së TMK-së dhe FSK-së të cilët përfitojnë edhe pensione tjera, vlera e të cilave ishte 565,829€.

Tabela 6. Përfituesit e më shumë se një pensioni nga skemat pensionale

Lloji i skemës pensionale	Numri i pagesave	Gabimi Financiar në Euro (€)
Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe DFDIL_Familjar	327	89,156
Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe DFDIL_Veteran	1	170
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe DFDIL_Familjar	2073	463,688
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe DFDIL_Veteran	14	2,097
Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL_Familjar	45	3,450
Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL_Veteran	26	2,175
Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL_Familjar	6	948
Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL_Veteran	9	1,496
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara (PPAK) dhe DFDIL_Familjar	13	975
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara (PPAK) dhe DFDIL_Veteran	7	569
DFDIL - Familjar dhe PIP	10	750
Trepça - DFDIL-Veteran	1	105
KV -DFDIL- Familjar	1	250
Gjithsej	2,533	565,829

Për çështjet më lartë, MPMS kishte kryer pagesa të tilla edhe në vitet paraprake deri në muajin shtator 2018 kur edhe ishin ndërprerë ato.

Megjithatë me vendim të Qeverisë NR.12/82 të dt. 28.12.2018 ishte aprovuar vazhdimi i pagesave të pensioneve të dyfishta për FSK-në dhe TMK-në deri në interpretimin përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale nga institucioni i ngarkuar me këtë kompetencë.

Lidhur me këtë, MPMS deri në përfundim të auditimit për vitin 2018 nuk kishte arritur të siguroj interpretim të bazës ligjore për skemat pensionale në fjalë apo të përditësojë kornizën ligjore aktuale siç parashihet edhe me Strategjinë Sektoriale 2018-2022 e aprovuar nga Qeveria.

Rreziku

Mangësitë e identifikuara më lartë që kanë të bëjnë me pagesën e pensioneve për personat e punësuar, pagesa e pensioneve pas vdekjes si dhe pagesat e pensioneve për personat të cilët janë përfitues nga më shumë se një skemë pensionale rrit rrezikun e pagesave pa bazë ligjore.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale duke shfrytëzuar mekanizmat ligjor te organet përkatëse të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për të bërë interpretime dhe vlerësime të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2018 ishte 743,356€, ndërsa ishin shpenzuar 685,607€ apo 92%. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e shtëpive për rastet sociale, renovimin e Qendrave të Aftësimiit profesional etj.

Lidhur më testet tonë, ne kemi identifikuar çështjen si në vijim:

Çështja A6 - Pranimi i pajisjeve jo në përputhje me specifikacionet e kërkuara

Gjetja Sipas nenit 1 të kontratës së lidhur ndërmjet MPMS-së dhe OE, për 'Furnizim me pajisje dhe vegla pune për Qendrat e Aftësimeve Profesionale' në vlerë 39,520€, dt.03.10.2018 - lënda e kontratës - specifikohet përshkrimi i pajisjeve, sasia dhe çmimi i paisjeve të cilat OE duhet to ofrojë.

Në Qendrën e Aftësimeve Profesionale në Ferizaj, kemi vërejtur se ishte bërë pranimi i tri (3) pajisjeve në vlerë 13,540€ të ofruara nga OE, specifikacionet teknike të cilave nuk ishin në përputhje me kontratën. Fillimisht ishte refuzuar pranimi i tyre nga komisioni pasi që kishte konstatuar se kishte dallime të mëdha në mes të specifikimeve teknike të pajisjeve të kontraktuara me paisjet që ishin sjellur nga OE. Mirëpo më vonë ishin pranuar po të njëjtat paisje edhe pse specifikimet teknike nuk ishin në përputhje me kontratën. Ndryshimet ishin tek pozicioni 38-(Makinë për ngjitjen e kant-trakes ABS-it), 40-(Sharrë tërheqëse me disk LS1216L) dhe 41-(Tavolinë për sharrat me disk DEAWST06).

Shkaku i pranimit të këtyre pajisjeve, ku specifikimet e tyre dallojnë nga ato të kontraktuara qëndron në faktin që Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) kishte caktuar dy trajner në cilësinë e eksperteve të cilët kishin dhënë mendimin e tyre se mjetet janë të mira dhe mund të kryejnë punë pavarësisht që dallojnë me specifikimet teknike të kërkuara.

Rreziku Pranimi i pajisjeve jo në përputhje me specifikat e kontratës, rrit rrezikun që ato të mos e kryejnë funksionin adekuat për qëllimin e kërkuar nga njësi kërkuese si dhe rrit rrezikun e pranimit të pajisjeve me cilësi më të dobët në raport me vlerën e parasë së shpenzuar.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të sigurojë që pranimi i të gjitha pajisjeve të bëhet konform kontratës me qëllim që të arrihen objektivat e njësisë kërkuese.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PFV ishte në vlerë 18,822,098€, pasuritë jo-kapitale nën 1,000€ ishin në vlerën 802,479€ ndërsa vlera e stoqeve ishte 6,123€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Lidhur me testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja C3 - Dobësi në menaxhimin e pasurive

Gjetja

Neni 2 i Rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurive, përcakton - që të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin, tjetërsimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit më efektiv, efikas dhe ekonomik, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi. Po ashtu kërkon që raporti i inventarizimit të kryhet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Lidhur me menaxhimin e pasurive ne kemi vërejtur si në vijim:

- MPMS kishte themeluar komisionin për inventarizim, mirëpo i njëjti nuk kishte arritur ta përfundoj këtë proces para përgatitjes dhe dorëzimit të PFV-ve; dhe
- Për shtatë nga 35 mostrat e testuara të pasurisë, të regjistruara në vitet e mëhershme (para vitit 2010) në regjistrin e pasurisë, ministria nuk ka ofruar dokumentacion mbështetës për to.

Shkaku i këtyre dobësive të identifikuara tek pasuritë ishte funksionimi jo i mirë i kontrolleve të brendshme lidhur me menaxhimin e pasurisë.

Rreziku

Mungesa e dokumenteve mbështetëse për pasuritë e regjistruara si dhe mos harmonizimi i gjendjes së inventarizimit me gjendjen në regjistrin kontabël, rrisin rrezikun që pasuritë të keqpërdoren, humben apo të tjetërsohen si dhe vlera e pasurisë së organizatës e pasqyruar në PFV të mos jetë e drejtë.

Rekomandimi C3 Ministri duhet të sigurojë kontrollet në menaxhimin, regjistrimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që ajo të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Më tutje duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 1,870,511€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019. Krahasuar me vitin paraprak 2017 ku vlera e obligimeve ishte 422,051€, këtë vit obligimet janë rritur për 1,448,460€. Sipas ZKF-së arsyeja e rritjes së obligimeve në vitin 2018 ka të bëjë me pensionet e FSK dhe TMK si dhe skemave tjera pensionale, të cilat për një kohë ishin ndërprerë nga MPMS-ja, mirëpo me Vendimin e Qeverisë Nr.12/82 i dt. 28.12.2018 ishte lejuar vazhdimi i pensioneve të dyfishta.

Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Ministria. Lidhur më testet tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim:

Çështja B2 - Raportim jo i plotë dhe dobësi në menaxhimin e obligimeve

Gjetja

Sipas nenit 39 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, organizata buxhetore duhet çdo faturë të vlefshme ta paguaj brenda afatit kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimin të faturës. Po ashtu, sipas Rregullores Nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, nenit 24, paragrafi 1.3, të gjitha faturat duhet të protokollohen dhe të evidentohet në librin e faturave. Më tutje, sipas Rregullores Nr. 02/2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara, organizatat buxhetore janë të obliguara që në Ministrinë e Financave të raportojnë në baza mujore faturat e pranuar dhe të papaguara.

Lidhur me këtë, MPMS nuk ka zbatuar plotësisht procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimin të faturave, ngase në tri raste faturat e pranuar në vlerë 138,046€ nuk ishin protokolluar. Madje në pesë raste, faturat apo obligimet ndaj furnitorëve në vlerë totale 274,010€ ishin paguar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh, vonesat ishin nga 44 deri në 730 ditë. Po ashtu, raportimi i obligimeve nuk ishte bërë në mënyrë të rregullt pasi që për tetë muaj gjatë vitit 2018 nuk ishin dërguar fare raporte në MF me arsyetimin se obligimet ishin zero.

Këto parregullsi kanë ndodhur pasi që kontrollet e brendshme nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente gjatë vitit.

Rreziku

Dobësitë në menaxhimin e obligimeve të pa paguara si dhe tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund të rezultojë me humbje të faturave dhe rrjedhimisht MPMS nuk do të ketë informacionin e duhur në kohë lidhur me obligimet paraprake. Njëherit ministria mund të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve. Po ashtu duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar protokollohen.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

MPMS gjatë vitit 2018 nuk ka shënuar ndonjë progres sa i përket qeverisjes së mirë, ende ekziston një numër i dobësive veçanërisht në lidhje me llogaridhënien dhe menaxhimin e rrezikut. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit nuk ishin vendosur plotësisht.

Sa i përket raportit të vetëvlerësimit MPMS ka dorëzuar atë në Ministrinë e Financave në afatin e paraparë. Po ashtu, Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme si dhe Komiteti i Auditimit ishte funksional.

Në aspektin e pajtueshmërisë me legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë kryesisht mos respektimin e plotë të legjislacionit në fuqi në fushat e subvencioneve, veçanërisht pagesës së pensioneve, menaxhimin e obligimeve dhe fusha e personelit të cilët janë trajtuar në kapitujt më lartë.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Për këtë, ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e komitetit të auditimit. Përveç kësaj, ne i kemi shqyrtuar veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) udhëhiqet nga Drejtori i NJAB-së dhe katër auditorë. Për vitin 2018, kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik, ku kishte planifikuar 22 auditime të rregullta dhe dy me kërkesë.

NJAB-ja gjatë vitit 2018 kishte funksionuar mirë, duke realizuar në tërësi planin vjetor të auditimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet apo masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Lidhur me këtë ne kemi identifikuar si në vijim:

Çështja C4 - Mungesa e regjistrit të rreziqeve

Gjetja Procedura e MFK-së nr.4, përcakton që secila organizatë buxhetore duhet të vendos politika të shkruara si dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve.

Për këtë, MPMS nuk ka politika të shkruara dhe as procedura për menaxhimin e rreziqeve. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, ku do të bëhej identifikimi i rreziqeve të pritshme kundrejt objektivave, përcaktimi i mënyrës së menaxhimit të tyre dhe njësitë përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme.

Lidhur me arsyen e mos hartimit të regjistrit të rreziqeve nuk është ofruar ndonjë arsyetim nga MPMS.

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut ndikon në cilësinë e objektivave pasi që rreziqet nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Rekomandimi C4 Ministri duhet të sigurojë hartimin e regjistrit të rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 kishte rezultuar në 16 rekomandime. Për këto, MPMS kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitej mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, pesë rekomandime ishin zbatuar, pesë ishin të përsëritura, katër ishin pjesërisht të zbatuara dhe dy rekomandime konsiderohen të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 7.

Tabela 7 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Po ashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.	MPMS kishte ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi, ku pas raportit të ZKA-së për vitin 2017 i kishte ndërprerë pagesat për përfituesit e më shumë se një skeme pensionale. Megjithatë Qeveria e Kosovës me datën 28/12/2018 kishte marrë vendimin Nr.12/82 për vazhdimin e pagesave të dyfishta.	I përsëritur.
2		Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e granteve dhe detyrimeve kontingjente sipas shumës së vlerësuar. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Te ky rekomandim ka mbetur pa u zbatuar vetëm pjesa që ka të bëjë me prezantimin e detyrimeve kontingjente.	Pjesërisht i zbatuar.

3	Procesi i buxhetit	Ministri duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për planifikimin jo të duhur të projekteve dhe vonesat në realizimin e procedurave për investime kapitale në 2017 dhe më herët si dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit të tij për vitin 2018. Po ashtu, duhet të sigurojë që të thellohet dialogu me MF-në rreth planifikimit të buxhetit me theks të veçantë tek skemat sociale dhe pensionale në mënyrë që të evitohen vështirësitë e vazhdueshme në realizimin e obligimeve ligjore dhe të synimeve paraprakisht të caktuara.	Në vitin 2018, MPMS kishte bërë kërkesat buxhetore me kohë.	I zbatuar.
4	Pagat dhe Shtesat	Ministri duhet të sigurojë që pagesa e zyrtarëve bëhet sipas përshkrimit të detyrave të punës, duke shmangur kështu mundësinë e pagesave të ndryshme për pozitat e njëjta.	Gjatë vitit 2018 MPMS kishte bërë kërkesë në MAP për ndryshim të koeficienteve dhe ishte në proces të realizimit.	I mbyllur.
5	Menaxhimi i personelit	Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta angazhohen me procedura rekrutuese sipas kërkesave ligjore.	Në pjesën më të madhe të MSHV-ve ishin zbatuar procedurat e thjeshtësuar të rekrutimit. Megjithatë në disa raste kanë vazhduar mangësitë e njëjta.	Pjesërisht i zbatuar.
6	Mallra & Shërbime	Ministri duhet të sigurojë se njësitë kërkuese bëjnë një analizë të detajuar të nevojave para se të iniciohen procedurat e prokurimit, duke siguruar kështu se në specifikacionin teknik përfshihen vetëm pozicionet e kërkuara. Po ashtu kontrata duhet të përmbajë sasinë dhe çmimin për njësi konform specifikacionit teknik të dosjes së tenderit. Gjithashtu duhet të siguroj se, në specifikacionin teknik të dosjes së tenderit përfshihen sasi të indikative dhe se kontrata kornizë nënshkruhet në pajtim LPP.	Gjatë testimeve tona, nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar.

7		Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme për të siguruar rregullsinë dhe efikasitetin e çdo procesi përmes së cilit kalon një shpenzim, duke reduktuar kështu mundësinë e ekzekutimit të pagesave nga Thesari.	Gjatë testimeve tona, nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar.
8	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj se janë përforcuar edhe më tutje kontrollet e brendshme, për të siguruar pastrimin e listave, duke bërë krahasimin sistematik të regjistrave me regjistrin civil, komunikim në kohë reale me shënimet e tyre, para se të bëhet kompensimi i pensioneve. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për kthimin e pensioneve të dhëna pa bazë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi. Shih rekomandimin A5.	I përsëritur.
9		Ministri duhet të siguroj forcimin e mëtejshëm të kontrolleve të brendshme, me qëllim të pastrimit të listave, në mënyrë që personat e punësuar të mos përfitojnë pensionet që nuk ju takojnë. Duhet të bëhen krahasimet sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK, komunikim në kohë reale, para ekzekutimit të pagesave. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat e nevojshme ndaj përfituesve, në mënyrë që mjetet e përfituara pa bazë ligjore të kthehen në buxhetin e ministrisë	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi. Shih rekomandimin A5.	I përsëritur.
10		Ministri duhet të sigurojë përmirësimin e vazhdueshëm të kontrolleve të brendshme për të krijuar një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale. Të analizohen mundësitë për krijim të një softueri të integruar të të gjitha skemave pensionale, në mënyrë që të eliminohet mundësia e përfitimeve të dyfishta të pensioneve. Po ashtu duhet të merren të masat ligjore në mënyrë që përfituesit t'i kthejnë mjetet e përfituara jashtëligjshëm në buxhetin e ministrisë.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi. Shih rekomandimin A5.	I përsëritur.

11	Investimet Kapitale	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha kontratat lidhen me OE të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Gjatë testimeve tona, nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar.
12	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i tyre të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Më tutje, duhet të sigurojë se në marrëveshjet e bashkëfinancimit me komunat, të qartësohet pronësia e objekteve të ndërtuara pas përfundimit. Gjithashtu duhet të shtohet bashkëpunimi i Zyrtarit të pasurisë me Thesarin për të mundësuar regjistrimin e investimeve të reja në objektet ekzistuese si vlerë e shtuar e objektit bazë.	Te ky rekomandim ka mbetur pa u zbatuar pjesa që ka të bëjë me inventarizimin e pasurisë si dhe mungesa e informatave për disa pasuri.	Pjesërisht i zbatuar.
13	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve. Po ashtu duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar protokollohen.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi.	I përsëritur.
14	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	Menaxhmenti kishte bërë përpjekje që ti adresoj rekomandimet tona si dhe ishte në proces të zbatimit të tyre.	I mbyllur.
15	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të sigurojë se një rishikim i kontrollit të cilësisë do të aplikohet për çdo dosje të auditimit nga Drejtori i NjAB dhe duhet të sigurohet se në raportin vjetor të KA do të shqyrtohet cilësia e dosjeve të auditimit të aplikuara nga NjAB.	Gjatë testimeve tona, nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar.

16	Menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, MPMS duhet të plotësojë dhe azhurnoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.	Te ky rekomandim ka mbetur pa u zbatuar pjesa që ka të bëjë me hartimin e regjistrit për menaxhimin e rreziqeve.	Pjesërisht i zbatuar.
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	PFV	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Po ashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme përmes komunikimit në kohë reale në mes të regjistrave me regjistrin civil, krahasime sistematike të listave të përfituesve me informatat e marra nga ATK si dhe të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet data bazave të skemave pensionale.		
2		Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë është mjaft i përhapur edhe në ministritë tjera.		
3		Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV për vitin 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shpалosjen e saktë të pasurive dhe detyrimeve kontingjente. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		
4		Ministri duhet të siguroj se regjistrimi i shpenzimeve bëhet në kode adekuate siç parashihet me planin kontabël të SIMFK-së me qëllim të prezantimit dhe shpалosjes së drejtë të informatave për shfrytëzuesit e PFV-ve.		

5	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të forcoj kontrollet e brendshme dhe të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të stafit, kriteret përcaktohen sipas legjislacionit përkatës duke respektuar në tërësi procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.
6		Ministri duhet të sigurojnë se janë marrë masa për të ndërprerë praktikën e lidhjes së kontratave pa procedura të rekrutimit dhe kohëzgjatja e këtyre marrëveshjeve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës.
7	Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të sigurojë se nuk do të ketë asnjë kompensim shtesë për stafin e angazhuar brenda orarit të rregullt të punës.
8	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit për skemat pensionale duke shfrytëzuar mekanizmat ligjor të organet përkatëse të cilat janë të ngarkuara me përgjegjësi për të bërë interpretime dhe vlerësime të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore.
9	Investimet Kapitale	Ministri duhet të sigurojë që pranimi i të gjitha pajisjeve të bëhet konform kontratës me qëllim që të arrihen objektivat e njësisë kërkuese.
10	Pasuritë kapitale dhe jo- kapitale	Ministri duhet të sigurojë kontrollet në menaxhimin, regjistrimin dhe raportimin e pasurisë, në mënyrë që ajo të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore. Më tutje duhet të sigurojë që komisioni ka përfunduar raportin e inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve.
11	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregulloren, si dhe të gjitha obligimet të prezantohen drejtë në raportin e obligimeve. Po ashtu duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar protokollohen.
12	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rreziqeve	Ministri duhet të sigurojë hartimin e regjistrit të rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e mundshme kundrejt objektivave.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA-VLADA-GOVERNMENT MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE Ministèremin Fitoz, Shqipëri Zepëritë, Kosovë Labour and Social Welfare Kosovo, Annullation: Artime, Artime, Artime	
Nr. Org. Org. Jedinca Org. Unit	Nr. Prot. Prot. No.
01	284
Nr. faqeve Br. Stranica No. pages	Data: Date:
	19.06.2019
Prishtine-Prishtina-Prishtina	



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANUAR DORËZUAR: DATE PRIL JEHO DOSTAVLJEN: DATE RECEIVED / SUBMITTED:			
19.06.2019			
Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47	1119	1

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Skender Reçica

Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale

Data: 19.06.2019, Prishtinë,